

NOTE INFORMUESE

Tiranë, më 05.04.2023

Mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor me masën “Pezullimi nga detyra për një periudhë prej dy vitesh”, ndaj gjyqtarit S.U.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka dërguar për procedim disiplinor për shkelje të ligjit procedural civil, që përbëjnë shkelje disiplinore, magjistratin S.U., gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, me nismën e ankuesit Shoqata “Toka” dhe Ministrisë së Drejtësisë, e vitit 2018, pjesë e fondit të dosjeve që ILD ka trashëguar nga institucione të mëparshme, e që i trajton me prioritet për shkak të afateve të parashkrimit.

Nga hetimi disiplinor i kryer nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, provohen se:

- Nga ana e magjistratit është konstatuar mospërmbyllje e detyrimeve ligjore me karakter urdhërues, që i ngarkon Kodi i Procedurës Civile në lidhje me shqyrtimin dhe zgjidhjen e një çështje konkrete.
- Shkelje që kanë të bëjnë me respektimin e urdhërimeve të një vendimi gjyqësor të formës të prerë dhe keqinterpretim të përmbajtjes të vendimit gjyqësor të referuar.
- Shkelje e rregullave procedurale mbi shfuqizimin/anulimin e veprimeve të kryerja nga përmbartuesi në kundërshtim me ligjin dhe pezullimin e veprimeve përmbartimore.
- Shkelje e rregullave procedurale mbi marrjen e masës të sigurimit të padisë.
- Shkelje e rregullave procedurale mbi paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesës për korrigjimin e gabimit material.
- Si rrjedhojë e shkeljeve të rënda procedurale të kryera është cenuar interesi publik, duke u lejuar vazhdimi i punimeve të ndërtimit të Hc “Dragobia”, Komuna Margegaj/Kukës.
- Magjistrati ka një vjetërsi në detyrë prej rreth 32 vitesh si gjyqtar, tregues ky i njohjes shumë të mirë të tij mbi rolin e ushtrimit të detyrës me disiplinë dhe profesionalizëm. Pavarësisht kësaj, gjyqtari ka dëmtuar imazhin e drejtësisë dhe besimin e publikut në të.

Magjistrati ka marrë dijeni për vendimin për fillimin e hetimit disiplinor nga ILD, por nuk ka paraqitur asnjë shpjegim/observacion apo qëndrim në lidhje me llojin dhe natyrën e shkeljeve të pretenduara, për të cilat filloi hetimi disiplinor ndaj tij.

Veprimet e ndërmarra nga ana e magjistratit z. S.U., përbëjnë “*Shkelje shumë të rënda disiplinore*” dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë i propozon KLGJ-së caktimin e masës disiplinore “*Pezullimi nga detyra për një periudhë prej dy vitesh*”, të parashikuar nga neni 110 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, shkronja “dh” dhe neni 102, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;